



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 80, Datë 02.05.2024

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“GREENNAT SOLAR PARK BALLSH” SH.P.K. PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 02.05.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 979/1 prot., datë 30.04.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “GreNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 979 prot., datë 23.04.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 100 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale 1090, Njësia Administrative Ballsh, Bashkia Mallakastër, Qarku Fier.
- Aplikuesi ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se aplikuesi ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të përcaktimeve të nenit 9 të Rregullores, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3 gërmat “a” dhe “c”; për pikën 2.1 gërmat “a”, “d”, “e” dhe “f”.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi konstatohet se nevojitet të plotësohet dokumentacioni në vijim:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

- *Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal*

Gërma “b”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës për mbështetjen financiare, referuar vlerës së investimit, sikurse përcaktuar në kontratën me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

- **gërma “b”:** Shoqëria duhet të depozitojë kontratën me MIE-n në format origjinal ose fotokopje e njëzuar me origjinalin.
- **gërma “c”:** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE miratimin përfundimtar/marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a. për miratimin e pikës së lidhjes me rrjetin e transmetimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 100 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale 1090, Njësia Administrative Ballsh, Bashkia Mallakastër, Qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

Erjola SADUSHI